

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

7 Shkurt, 2022

Të nderuara familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Drejtoria Arsimore e Filadelfias është e gëzuar t'ju njoftojë se të Ejten, më 10 Shkurt 2022, do të publikojmë Raportin e Progresit të Shkollës për Arsimin dhe Barazinë për vitin shkollor 2020-2021 (SPREE).

[SPREE](#) zëvendëson Raportin e vjetër të Progresit të Shkollës (SPR) i cili jepte informacion për arritjet e secilës shkollë dhe fushat për përmirësim. SPREE është një mjet i përmirësuar që përputhet më ngushtë me [Objektivat dhe Qëllimet e Bordit të Arsimit](#), i cili vendos kërkesa të qarta për atë që nxënësit duhet të jenë në gjendje të arrijnë dhe kushtet që duhet të ekzistojnë në çdo shkollë për t'i fuqizuar studentët tanë që të kenë sukses dhe përtej klasës. SPREE thekson progresin tonë të përgjithshëm si drejtori dhe tregon rritjen e secilës shkollë në të dyja matjet tradicionale të performancës si aftësia në vlerësimet shtetërore dhe normat e diplomimit, ashtu dhe masat shtesë të ambientit, kulturës dhe mundësive të shkollës.

Siç e dimë shumë mirë, viti 2020-2021 nuk ishte një vit normal shkollor. Për shkak se pandemia na detyroi të kalojmë në mësimin virtual, shumë studentë nuk morën vlerësime shtetërore si Keystones dhe PSSA. Prandaj, për shkak se të dhënat e vlerësimit informojnë masa të ndryshme SPREE, **raporti për vitin shkollor 2020-21, i cili do të quhet *SPREE Lite*, do të duket paksa i ndryshëm nga raportet e ardhshme.** Ai nuk do të përfshijë informacionin e performancës në fushat e Letërsisë dhe Gjuhës Angleze ose Matematikës dhe Shkencës, as nuk do të përfshijë rezultatet e përgjithshme. Në vend të kësaj, SPREE Lite e secilës shkollë do të tregojë listën e të gjitha metrikave që do të vlerësohen në raportet e ardhshme SPREE, por do të ofrojë vetëm informacione të performancës për masat që mund të vlerësojmë në këtë moment - Gatishmëria për Kolegjin dhe Karrierën, Ambientin, Kultura dhe Mundësitë .

Ne kemi zhvilluar disa burime të dobishme për t'ju ndihmuar në leximin dhe kuptimin e SPREE. Ky [Udhëzues Familjar/Family Guide](#) ofron një përmbledhje të SPREE dhe se si lidhet me Objektivat dhe Qëllimet. Ky [Udhëzues Përdoruesi/User Guide](#) ofron informacion më të detajuar dhe teknik në lidhje me mënyrën se si ne llogaritim rezultatet për secilën masë. Dhe së fundi, ky [FAQ](#) do t'u përgjigjet pyetjeve shtesë që mund të kenë. Të gjitha këto burime dhe të tjera mund të gjenden në faqen e internetit SPREE në www.philasd.org/spree.

Faleminderit për partneritetin me Drejtorinë ndërsa ne përpiqemi së bashku t'i ndihmojmë të gjithë studentët të kenë sukses!

Singerisht,

A handwritten signature in cursive script that reads "William R. Hite Jr.".

William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias